



FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS
REMUSICA 2019


Tel.: + 383 (0)49622260

Address: Kroi Bardhë D-V / 9 10000 Prishtinë KOSOVA
www.remusicafestival.com



ReMusica
PRISHTINA INTERNATIONAL FESTIVAL
24.05 > 02.06 2019

day after tomorrow



18th edition
www.remusicafestival.com

EDITORIAL

Festivali Ndërkombëtar i Prishtinës ReMusica | Edicioni 18
Dare to Love | Guxo të Dashurosh

Me programin e sivjemë, Edicioni i 18-të i festivalit ReMusica, do të ketë një shtrirje të gjërë, në prezantimin e ansambleve të ndryshme kamertale dhe solistëve eminentë, duke synuar që programi i prezantuar, të bëhet urë lidhëse në mes tendencave novatore që shfaqen në skenën koncertore europiane dhe publikut tonë prishtinas, një publikë me përvojë jo të gjatë, ndonëse gjithmonë kureshtarë dhe dashamirës.

Edicionin e 18 të ReMusicas këtë vit do ta hapë trioja zagrebase **Guitar Trio Elogio**, formacion kitarash, shumë i respektuar në skenën koncertore kroate. Trion e përbëjnë instrumentistë, Tomisllav Vukshiq, Pedro Ribeiro Rodrigues, të udhëhequr nga kitaristi kosovar me famë botërore Petrit Çeku.

Mysafir tjetër me renome i këtij edicioni, do të jetë edhe virtuoz, në instrumentin e tubës, **Thomas Leleu**, pamëdyshje, sot paraqet atraksion të vërtet në skenën franceze dhe europiane, në përgjithësi, në një anë për virtuoze të tij të jashtëzakonshëm, si edhe për faktin se ai luan në një instrument që, deri vonë, nuk është konsideruar instrument solistik. Ndër tjera, Lelu, është fitues i çmimit prestigjioz Victoire de la Musique (French Grammy Awards). Në vazhdim të festivalit, Duoja atraktive nga Austria, **Vira Zhuk dhe Mariam Vardzelashvili** do të sjellin kartolinën nga Austria dhe do të jenë pjesë e koncertit të titulluar « Nga Austria me Dashuri ». Koncertet me ansamble dhe autorë më eminent shqiptarë nga Tirana e Prishtina, si gjithmonë, do të zënë vend të rëndësishëm në programacionin e sivjemë. Po përmendim ansamblin **3x Quartett | OPERA KUartet**, i përbërë nga 6 instrumentistë të Orkestrës së Teatrit Operas dhe Baletit Tiranës dhe pedagogë të Universitetit të Arteve në Tiranë. **Merita Rexha Teršana & Vikena Kamenica**, solistet nga Shqipëria do të sjellin projektin e vecantë, veprën kulte të lidit gjerman në formën integrale të saj, « Udhëtimi dimëror » të Franz Schubert. Thellësinë poetike të kësaj kryevepre të muzikës romantike do të na bëjë edhe më të afërt, poezia që do të shoqëroj muzikën e Shubertit.

Koncertet tematike të festivalit, **ReMusica Junior** dhe **Nata Multimedia/Akusmatike** edhe këtë vit synojnë promovimin e muzikës akusmatike dhe botës tingullore të saj. Koncerti i muzikës akusmatike në oktofonin dhe Video Performancë, e sjellë kompozitori, sound – designer dhe videografi, **Clement Parmentier**, nga Belgjika përmes 8 altoparlantëve dhe spacializimit e veprave të cilat eksplorojnë strukturat dhe shtresat tingullore. Krahas koncerteve të mbremjës, si gjithmonë ReMusica do të sjellë segmente tjera dhe programe shtesë, si **'ReMusica Edukative'**, ku publiku në mënyrë të drejtpërdrejtë do të jetë afër me muzikën, interpretin, instrumentin dhe kompozitorin. Publiku, i përbërë prej të gjitha moshave, do ta ketë mundësinë të shijojë koncertet e shkurtëra dedikuar instrumenteve të veçanta.

Në pasurimin programor të festivalit, si edhe në vitet e mëparshme, kontribut të çmueshëm do të japin dy koncertet e ansambleve tona me renome :Kori i Filharmonisë (30 maj) dhe Orkestra Simfonike e Filharmonisë me koncertin e saj përmbyllës të festivalit (2 qershor). Përpos agjendës së mbushur koncertale, gjatë ReMusicas nuk do të mungojnë masterklaset, ligjëratat si dhe tribuna muzikologjike. Duke vazhduar traditën e shenimit të përvjetorëve, ReMusica sivjet shenon 110 vjetorin e lindjes së pionerit të muzikës kosovare - Lorenc Antoni. Njëkohësisht do të shenohet 70 vjetori i lindjes së kompozitorit dhe dirigjentit Rafet Rudi.

EDITORIAL

Prishtina International Festival ReMusica | 18 Edition
Dare to Love | Guxo të Dashurosh

This 18th Edition programme of ReMusica Festival, with wide scope will present various chamber ensembles and eminent soloists, aiming that the presented programme establish the hub between innovative tendencies present at the European concert stage and Prishtina public, a public with not a long experience, although always curious and benevolent.

18th Edition of ReMusica will be opened by **Guitar Trio Elogio** a guitar formation established in Zagreb, very much respected at the Croatian concert scene. Trio is composed of Tomislav Vuksic, Pedro Ribeiro Rodrigues, and lead by Kosovar renowned guitarist Petrit Çeku.

Another prominent guest of this edition will be a tuba virtuoso **Thomas Leleu**, who with no doubt today represents a true attraction on French and European scene, namely for his outstanding virtuosity, as well as for the fact that he plays on an instrument which until very late was not considered as a solo instrument. Among others, Leleu is the winner of the prestigious Victoire de la Musique (French Grammy Awards). Festival will also present an attractive duo from Austria, **Vira Zhuk and Mariam Vardzelashvili**, who will bring the 'postcard' from Austria presented at the concert "From Austria with Love". As always, an important part of the festival will present concerts with eminent Albanian ensembles and authors from Tirana and Prishtina. We should distinguish the **3xQuartet | OPERA KUartet** ensemble, composed of six players from the Tirana Opera and Ballet Orchestra, as well as professors from Tirana Art University. **Merita Rexha Teršana and Vikena Kamenica**, soloists from Albania will bring a special project, a cult German piece in its integral form, "Winterreise" of Franz Schubert. The poetic depth of this romanticism master piece will be represented by the poetry which will follow the music of Schubert.

Thematic concerts of the Festival, **ReMusica Junior** and **Multimedia/Acoustic Night** this year also aim in promoting the acoustic music and its sound world. The octaphonic acoustic music concert and video performance will be represented by the Belgian composer, sound-designer and videographer, **Clement Parmentier**, through eight speakers and spacialization of pieces who explore sound structures and layers. Besides main concert events, as always ReMusica represents additional substantial programme, as **'Educational ReMusica'**, where the public directly will be closer to the music, the player, the instrument as well as the composer. The public, which entails all age groups, will have the opportunity to enjoy short concerts dedicated to special instruments.

The added value to the Festival programme, as in the previous years, will be brought by two of our famous ensembles, the Philharmonic Choir and Symphonic Orchestra of the Kosovo Philharmonics. Besides full concert agenda, ReMusica will be followed by additional activities such as mastercourses, lectures and music tribune. This year ReMusica also celebrates the 110 birth anniversary of the Kosovar music pioneer, Lorenc Antoni, as well as 70 birth anniversary of the composer and conductor Rafet Rudi.

24 Maj May | Amfiteatri i Biblotekës Universitare | 20:00

TRIO GUITAR ELOGIO

PETRIT ÇEKU kitarë *guitar*
PEDRO RIBEIRO RODRIGUES kitarë *guitar*
TOMISLAV VUKŠIĆ kitarë *guitar*

25 Maj May | Amfiteatri i Biblotekës Universitare | 20:00

FROM AUSTRIA WITH LOVE | NGA AUSTRIA ME DASHURI

VIRA ZHUK violinë *violin*
MARIAM VARDZELASHVILLI piano

26 Maj May | Amfiteatri i Biblotekës Universitare | 20:00

POEZI & MUZIKË – Winterreise | Udhëtim Dimëror

VIKENA KAMENICA mezzo-soprano
MERITA REXHA TËRSHANA piano

27 Maj May | Amfiteatri i Biblotekës Universitare | 10:30

ReMusica Edukative:

Pranvera Hoxha piano | Lulzim Lushtaku kontrabas *contrabass*

Amfiteatri i Biblotekës Universitare | 20:00

PIANO RECITAL

REDI LLUPA piano

28 Maj May | Amfiteatri i Biblotekës Universitare | 10:30

ReMusica Junior: Bota e Tingujve

Amfiteatri i Biblotekës Universitare | 18:00

SKENA E RE Belgjikë – Kosovë

ARTS² École Supérieure des Arts (Studentët e Konzervatorit Mbretëror të Monsit)
dhe Dega e Artit Muzikor UP Prishtinë
Klasa e: prof. Clement Parmentier BE & prof. Donika Rudi KS



28 Maj May | Amfiteatri i Biblotekës Universitare | 20:00

BELGIAN ACOUSMATIC & VIDEO-MUSIC NIGHT

CLÉMENT PARMENTIER kompozitor *composer*, sound designer,
videograf *videographer*, spacializues *spacializer*

29 Maj May | Amfiteatri i Biblotekës Universitare | 20:00

3x QUARTETT | OPERA KUARTET

FATOS BARDULLA violinë *violin* ERIK TAUZI obo *oboe*
ALESIA SADIKU violë *viola* ERENK BEHLULA klarinet *clarinet*
LORETA MEMAJ violonçel *cello* ORGES MALAJ fagot *bassoon*

30 Maj May | Amfiteatri i Biblotekës Universitare | 20:00

KORI I FILHARMONISË SË KOSOVËS

KOSOVO PHILHARMONIC CHOIR

ORGES MALAJ fagot *bassoon*
RAFET RUDI dirigjent *conductor*

31 Maj May | Amfiteatri i Biblotekës Universitare | 20:00

RECITAL TUBE

THOMAS LELEU tubë *tuba*
ARTEMIDA QARRI HAXHIAJ piano

2 Qershor June | Salla e Kuqe *Red Hall* | 20:00

ORKESTRA E FILHARMONISË SË KOSOVËS

KOSOVO PHILHARMONIC ORCHESTRA

THOMAS LELEU tubë *tuba*
DANIEL BOEKE klarinetë *clarinet*
GREGORY CHARETTE dirigjent *conductor*



24 Maj May

Amfiteatri i Bibliotekës
Universitare | 20:00

TRIO GUITAR ELOGIO

PETRIT ÇEKU kitarë | guitar

PEDRO RIBEIRO RODRIGUES kitarë | guitar

TOMISLAV VUKŠIĆ kitarë | guitar

Hapja | Opening of ReMusica Festival 2019

Wolfgang Amadeus Mozart

(arr. P. Çeku)

Sonata No. 8, K.310

Allegro maestoso

Andante cantabile con espressione

Presto

Marko Ruždjak

April is the Cruellest Month

Rafet Rudi

Three Albanian Folk Songs

Valle

Asaman o trandofili çelës

Këngë Labe

Manuel de Falla

From "Three-Cornered Hat"

(arr. D. Petrinjak)

Dance of the Miller (Farruca)

Dance of the Neighbors (Seguidillas)

Dance of the Miller's Wife (Fandango)

Antonín Dvořák

(arr. D. Petrinjak)

Three Slavonic Dances

Allegro assai, op. 46, br. 7

Allegretto grazioso, op. 72, br 2

Presto, op. 46, br. 8

GUITAR TRIO ELOGIO u themelua nga Petrit Çeku, Pedro Ribeiro Rodrigues dhe Tomislav Vukshiq. Me origjinë nga vendet e ndryshme, trioja u bë bashkë në klasën e mirënjohur të Darko Petrenjakut në Akademinë e Muzikës në Zagreb.

Të motivuar nga dëshira për të luajtur pjesë të kompozitorëve të mëdhenjë, pjesë këto që nuk janë të mundura të luhen në kitarë, Trio Elogio performon shumë aranzhime të pianos dhe muzikës orkestrale. Megjithëate, duke ju falenderuar trashëgimisë kitaristike të trios nga Zagrebi – Trio Elogio poashtu luan pjesë origjinale të shkruar enkas për ansamblin.

Koncertet e Trio Elogios në Kroaci, Portugali, Kosovë, Austri, Zvicërr, Holandë dhe Poloni kanë qënë shumë mirë të pranuar si nga publiku ashtu edhe nga kritikët. Ansambli poashtu luajti pjesë premierë të kompozitorëve Kreshimir Seletkoviç, Rafet Rudi dhe Gerard Drozd.

Trio Elogio ishte pjesë e përpjekjeve për renovimin e Pallatit Gvozdanoviç në Zagreb duke mbajtur recital aty, i cili është prodhuar dhe transmetuar nga Radio Televizioni Kroat. DVD-ja e inçizimit nga koncerti i njejtë është publikuar nga Orfej.

Trioja (Elogio) ishte e gjallë gjatë gjithë koncertit dhe tingëlloi si një instrument me qindra ngjyra dhe publiku që mahnitur, veçanërisht nga ritmet spanjolle të cilat zgjuan temperaturën në sallë.

-Dubrovnik Press



25 Maj May

Amfiteatri i Biblotekës
Universitare | 20:00

FROM AUSTRIA WITH LOVE
NGA AUSTRIA ME DASHURI

VIRA ZHUK violinë | violin

MARIAM VARDZELASHVILI piano

E. Chabashvili
'Four Elements'

Franz Schubert
Fantasy in C major D. 935

Sergei Prokofiev
Sonata N1. f minor op. 80

Bernhard Gander
Impaling Prophecy


Aleksander Peci
Valle

VIRA ZHUK & MARIAM VARDZELASHVILI janë dy artiste të pavarura që krijuan ansambël intim të muzikës kamertale. Ato janë fituese të **Bak Austria Prix d'Art 2018**. Duoja fascinon publikun me një qasjë tejet individuale dhe të re të veprave dhe magjeps me prezencë kumbuese skenike. Të bashkuara me idenë e zbulimit dhe zgjerimit të kufijëve të repertoarit për violinë dhe piano, dy muzikantet gjetën një qasje të re të veprave kulmore për dy instrumentet, si dhe porositen vepra të kompozitorëve kryesor austriak, gjeorgjian dhe ukrainas.

Vira Zhuk dhe Mariam Vardzelashvili krijuan përzierje të influencave muzikore nga vendet e tyre të origjinës me traditën vjeneze të krijimtarisë së muzikës kamertale, duke ruajtur dhe modernizuar zhanrin.

Së fundi, duoja performoi në skena prestigjioze si dhe seri koncertale siç është Alte Rathaus Wien dhe Palais Atzenbrugg 'Schubertiade' në Austri, Phelps Mansion Museum në Nju Jork, West Virginia University Bloch Hall në SHBA, Tarapaca Musica Festival në Kili, Clasclas Festival në Spanjë, National Parliamentary Library në Gjeorgji, etj.

Në vitin 2018 duoja publikoi CD-në e tyre #onthemove dedikuar tri qyteteve me rëndësi në jetën e tyre, Vjenës, Kievit dhe Tbilisit. Disa porosi dhe premiera, si dhe repertoar kryesor të F. Schubert mund të ndëgjohen në inçizim.



26 Maj May

Amfiteatri i Bibliotekës
Universitare | 20:00



POEZI & MUZIKË - Winterreise | Udhëtim Dimëror

VIKENA KAMENICA mezzo-soprano

MERITA REXHA TËRSHANA piano

Franz Schubert

Die Winterreise

- | | |
|---------------------------------------|--|
| 1. Gute Nacht Good Night | 16. Letzte Hoffnung Last Hope |
| 2. Die Wetterfahne The Weather Vane | 17. Im Dorfe In the Village |
| 3. Gefror'ne Tränen Frozen Tears | 18. Der stürmische Morgen The Stormy Morning |
| 4. Erstarrung Numbness | 19. Täuschung Delusion |
| 5. Der Lindenbaum The Linden Tree | 20. Der Wegweiser The Sign Post |
| 6. Wasserflut Flood Water | 21. Das Wirtshaus The Inn |
| 7. Auf dem Flusse On the River | 22. Mut Courage |
| 8. Ruckblick Backward Glance | 23. Die Nebensonnen The False Suns |
| 9. Irrlicht Will-o'-the-Wisp | 24. Der Leiermann The Organ-Grinder |
| 10. Rast Rest | |
| 11. Frühlingstraum Dream of Spring | |
| 12. Einsamkeit Solitude | |
| 13. Die Post The Post | |
| 14. Der greise Kopf The Grey Head | |
| 15. Die Krähe The Crow | |

Avni Mula

O moj e bukura Arbëri

VIKENA KAMENICA është një nga artistet më rrëzëllitëse të gjeneratës së saj në Shqipëri. Bija e dy këngëtarëve operistikë, ajo shkëlqen në Akademinë e Muzikës në Tiranë me diplomimin e saj në vitin 2001, për të vazhduar më pas rrugëtimin studimor në “CEE Music-Theater” të Vienës gjate te cilit kryen Masterclass me Ileana Cotrubas dhe Bernd Weikl.

Në vitin 2009 ajo kurorëzohet me çmimin prestigjioz të Kulturës “Çmimet KULT”, ku cilësohet si “Këngëtarja më e mirë e vitit”. Që prej shtatorit të vitit 2001 ajo është e emëruar si soliste në “Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit” në Shqipëri, ku ka interpretuar një sërë rolesh, si: Fidalma tek “Il matrimonio segreto” e Cimarosa-s, Suzuki tek “Madame Butterfly” e Puccini-t, Flora tek “La Traviata” e Verdit, si dhe roli i Anitës tek musical-i “West Side Story” e Bernstein-it; etj

Ajo ka shkelqyer në skenë me një produksion të ri në Bukuresht dhe në Timisoara-Rumani me interpretimin në rolin e Cherubin-it (“Martesa e Figaros”), si dhe në “Festival de Sedieres”-France në rolin e Rosinës (“Berberi i Seviljes”). Vikena ka korrur një sukses të jashtëzakonshëm në rolin e Carmen-it, tek “Carmen” e Bizet, si dhe në rolin e Meg Page tek opera “Falstaff”, Prinz Orlovsky tek “Die Fledermaus” e Strauss. Një vend të rëndësishëm në karrierën e saj zënë dhe koncertet e ndryshme me orkester si “El amor brujo” dhe “Canciones Españolas” e Manuel De Falla, etj. Ajo ka punuar me dirigjentë të njohur, si M. Berdondini, V. Parisi, F. Pirona, G. Finzi, M. Mayrhofer, etj si dhe me regjisorë si M. Ranieri, P. Panton, N. Rhodes etj

Vikena Kamenica është një artiste shumë e dashur për publikun shqiptar, një kameleont i skenës muzikore shqiptare, me një personalitet artistik të theksuar.

MERITA REXHA TERSHANA është një nga pianistet më aktive në skenën muzikore shqiptare. Ajo përfundoi studimet e larta në klasën e prof. Margarita Kristidhi në Akademinë e Arteve në Tiranë dhe më pas ka ndjekur disa kurse pasuniversitare në Gjermani me profesorë të njohur si Paul Badura-Skoda, Till Engel, etj. Ka luajtur si soliste me orkestrat e Radio Television Shqiptar, Teatrit të Operas e Baletit, Filarmoninë e Tiranës dhe Kosovës etj. Ka marrë pjesë e ftuar në festival prestigjioze si soliste dhe në asamble të muzikës së dhomës, si në Schleswig Holstein Musik Festival në Gjermani, Bregenz Festspiel në Austri, etj. Është e ftuar prej shumë vitesh në festivalet më prestigjioze të rajonit si në Festivalin ReMusica në Kosovë, Ohrid Summer Festival, Pianodrom, Festivalin ndërkombëtar I muzikës së dhomës dhe vitin e fundit në Different trains Festival dhe Ballkan contemporary music festival. Ka interpretuar në vende të ndryshme si Gjermani, Austri, Japoni, Danimarkë, Zvicër, Itali etj. Ka bashkëpunuar me instrumentistë të njohur si Klaidi Sahatçi, Ermir Abeshi, Areta Zhulla, Thomas Leleu etj. Në vitin 2009 ka regjistruar një cd me vepra të Schumann-it. Në Shqipëri është fituese e shume çmimeve, ndër to fituese dy herë e çmimit Kult si Interpretuesja më e mirë e vitit. Punon në Universitetin e Arteve në Tiranë dhe që nga si pedagoge në Katedrën e Pianos. Ka titullin Profesor I Asociuar që prej vitit 2007.



27 Maj May

Amfiteatri i Biblotekës
Universitare | 20:00

PIANO RECITAL

REDI LLUPA piano

Complete piano Sonatas of George Walker
Priemerë Europiane: Cikli i sonatave të George Walker

George Walker

Sonata Nr. 2

I - Theme and Variations
II - Presto
III - Adagio
IV - Allegretto Tranquillo

Sonata No. 5

Sonata No. 4

I - Maestoso
II - Tranquillo

Sonata Nr. 3

I - Fantoms (Fantazmat)
II - Bell (Këmbana)
III - Choral and Fughetta (Koral dhe Fugetë)

Sonata Nr. 1

I - Allegro Energico
II - Theme and Variations
III - Allegro Con Brio

Valton Beqiri

Ala ToCcata

REDI LLUPA pianisti shqipëtar ka spikatur me performancat e tij në Europë, Amerikë të Veriut, Amerikë të Jugut, dhe Azi. Repertori i tij përmbledh muzikë nga kompozitorë të njohur të epokave të ndryshme nga Baroku deri tek shekulli XXI. Si një pianist i përkushtuar ndaj muzikës bashkëkohore, Z. Llupa vazhdimisht bashkëpunon me kompozitorë.. Që nga viti 2015, Z. Llupa bashkëpunoi me të madhin George Walker, fitues i çmimit Pulitzer në 1996. Z. Llupa ishte pianisti i parë që performoi ciklin e sonatave për piano në një koncert. Duke vlerësuar lartësisht lojën e tij, George Walker gjithashtu e ftoi personalisht për të performuar në 95 vjetorin e tij. Z. Llupa do të regjistrojë albumin e sonatave me shtëpinë diskografike ÉLAN Recordings. Si artist dhe lektor, Z. Llupa është ftuar nga universitete prestigjioze si: Eastman School of Music, University of North Texas, Louisville, Oregon, Miami, Virginia etj. Performanca të pianistit që spikaten janë në salla prestigjioze si Weill Recital Hall - Carnegie Hall, Parco Della Musica në Romë, dhe shumë të tjera. Redi Llupa është gjithashtu një nga themeluesit e Kaleidoscope MusArt Inc., një organizatë jo-fitim prurëse në Miami, me qëllimin e përkrahjes të artistëve të rinj dhe kompozitorëve bashkëkohorë.

Me kolegun e tij, violonçelistin Juan Sebastian Delgado, Z. Llupa ka ndërrmarë aktivitete si koncertore po ashtu edhe pedagogjike. Në vitin 2011, nisma e tyre për të zhvilluar një plan mësimor për fëmijët e favelave në Natal dhe Mossoro të Rio Grande do Norte në Brazil, u përzgjedh si projekt fitues i *100 Davis Projects for Peace*. Duo Llupa-Delgado vazhdimisht japin premiera të kompozimeve të reja. Në vitet 2013-2016, Z. Llupa kryen studimet e Doktoraturës në Frost School of Music të Universitetit të Miami si student dhe asistent i virtuosit Santiago Rodriguez. Që në 2016, Dr. Llupa mban titullin e *Doctor of Musikal Arts*.



28 Maj May

Amfiteatri i Bibliotekës Universitare | 18:00

SKENA E RE Belgjikë – Kosovë

ARTS² École Supérieure des Arts dhe Dega e Artit Muzikor
UP Prishtinë / Klasa e: prof. Clément Parmentier BE & prof.
Donika Rudi KS

Amfiteatri i Bibliotekës Universitare | 20:00

BELGIAN ACOUSMATIC & VIDEO-MUSIC NIGHT

CLÉMENT PARMENTIER kompozitor *composer*, sound designer,
videograf *videographer*, spacializues *spacializer*

Bernard Parmegiani

La roue ferris

Beatriz Ferreyra

La ba balle du chien chien à la mé mère

Clément Parmentier

Trou noir

Clément Parmentier

Je m'en fous

Manah Depauw & Jen Debauche

Gemini

Clément Parmentier

Rêve éveillé # 2

CLEMENT PARMENTIER i lindur me 1987, si i ri ndjeu nevojë për të krijuar, kompozuar dhe performuar. Ai vendosi që të ndjekë rrugën e artit duke u trajnuar së pari në timpana gjatë fëmijërisë së tij, që i mundësoi atij të zbuloj parkusionet dhe ritmin. Në vitin 2000 filloi kompozimin si autodiktat, muzikën elektronike si dhe mësimin lidhur me inçizimit të zërit.

Më 2006, u regjistrua në Konservatorin Mbretëror të Monsit në degën e muzikës, respektivisht kompozimit, në sektionin elektroakustik/akusmatik, nën drejtimin e kompozitores Annette Vande Gorne. Më 2011, magjistroi në muzikë, dega e kompozimit, Muzika Elektroakustikë (duke përfshirë specializimin në dizajn të tingullit, *sound design* dhe editimin e tingullit filmik- *sound editing*) dhe në anën tjetër vazhdoi me studimet post diplomike. Ai magjistroi në Studimet e Avancuara në bashkëpunim me Universitetin e Lirë të Brukselit, duke perfeksionuar shkathtësitë e tij shkencore të shkrimit dhe hulumtimit.

Fushat e kinemasë, zëri dhe videoja integrohen në vazhdimësi në produktionet e tij artistike. Ai kishte mundësinë e bashkëpunimit me videografët, kompozitorët, performuesit e muzikës instrumentale dhe teatro. Ai është aktiv në fushën e studimit të lartë të arteve dhe ligjeron kompozimin e ndihmuar nga kompjuteri, si dhe dizajnin e tingullit në Konservatorin Mbretëror të Monsit ARTS² dhe Institutin e Lartë të Muzikës dhe Pedagogjisë në Namur IMEP.



29 Maj May

Amfiteatri i Bibliotekës
Universitare | 20:00

3x QUARTET | OPERA KUARTET

FATOS BARDULLA violinë | violin

ALESIA SADIKU violë | viola

LORETA MEMAJ violonçel | cello

ERIK TAUZI obo | oboe

ERENIK BEHLULA klarinet | clarinet

ORGES MALAJ fagot | bassoon

Kushtrim Gashi

Trio

Koha II & III

François Devienne

Bassoon Quartet op.73 No.1 in C major

Wolfgang Amadeus Mozart

Oboe Quartet in F major KV370

Carl Stamiz

Clarinet Quartet in E flat major No.4

OPERA KUARTET është cilësuar si një nga grupet më interesante të muzikës dhomës. Në nivel kombëtar po ashtu ndërkombëtar, është ftuar rregullisht në festivale të ndryshme. **Opera Kuartet** është i përbërë nga instrumentistë të Orkestrës së Teatrit Operas dhe Baletit Tiranë (TKOB) si dhe nga pedagogë të Universitetit Arteve Tiranë.

Që nga themelimi i tij në vitin 2009, përbëhet nga instrumentistët e shquar të skenës shqiptare: **Orges Malaj, fagot**, fitues i shumë çmimeve dhe konkurseve në vend. Ai është fagotist i parë pranë Orkestrës Sinfonike të TKOB, Filharmoninë e Tiranës etj. Malaj aktualisht është pedagog në Fakultetin e Muzikës në Universitetin e Arteve në Tiranë. **Fatos Bardulla, violinë, Erenik Behlula, klarinet, Erik Tauzi, Oboe dhe Loreta Memaj, violonçel**, krahas koncertimeve të shumta në vend dhe Europë janë anëtar të rregullt dhe pjesë e TKOB, përderisa **Alesia Sadiku, violë**, vazhdon të jetë pjesë e orkestrave në vend, si Orkestren Sinfonike të Radio Televizionit, Filarmoninë e Tiranës, Orkestra Rinore Shqiptare, Palestinian Youth Orchestra si dhe pjesë e ansambleve, formacioneve të ndryshme kamertale.

Në repertoin e tij **Opera Kuartet** numëron disa koncerte të ndryshme në Tiranë, Prishtinë, Tetovë, Shkup, me një program të pasur nga repertori i Muzikës Klasike Romantike por edhe nga ajo Kontemporane. I vlerësuar nga kritika si “një nga Kuartetet më me unitet tingujsh midis njëri tjetrit”.



30 Maj May

Amfiteatri i Bibliotekës
Universitare | 20:00

KORI I FILHARMONISË SË KOSOVËS KOSOVO PHILHARMONIC CHOIR

ORGES MALAJ fagot | bassoon

RAFET RUDI dirigjent | conductor



Shenimi i 110 vjetorit të lindjes së kompozitorit Lorenc Antoni dhe 70 vjetori i lindjes së kompozitorit/ dirigjentit Rafet Rudi

Lorenc Antoni

Shkojti çika

Egil Hovland

Agnus Dei

concert for Bassoon and Choir

John Leavitt

Missa Festiva

Dafina Zeqiri

Duaj

Endri Sina

Muzg vjeshte

Olivier Messiaen

O sacrum convivium

Stephen Leek

Kondalilla

Jaakko Mäntyjärvi

Pseudo Yoik

Rafet Rudi

In A for Choir and ensemble

Adelina Paloja soprano

Kaltrina Miftari soprano

Grupi vokal: Kaltrina Miftari, Selviqe Marteti,

Shkurte Hykaj, Dea Xhemajli, Donika Rushiti,

Safet Berisha, Liridon Sadriu, Granit Musliu,

Lirim Thaqi, Endrit Rexhepi, Shqipërim Isufi,

Shaban Behramaj, Nikolla Gjini

Artemida Qarri-Haxhiaj piano

Melos Buza piano

Patris Berisha perkusione *percussions*

Meriton Zajmi perkusione *percussions*

Kenan Bytyqi perkusione *percussions*

KORI I FILHARMONISË SË KOSOVËS është ansambël profesionist me 50 anëtarë, i cili vazhdon punën e Korit Profesional të Radiotelevizionit të Prishtinës dhe u bë i njohur në vitet 80 pikërisht në drejtimin e dirigjentit aktual Rafet Rudi. Duke iu falenderuar dirigjentit, kori i është përkushtuar interpretimit të literaturës bashkëkohore e poashtu edhe asaj të renesancës dhe barokut. Kori së bashku me orkestrën e Filharmonisë së Kosovës kanë interpretuar një sërë veprash të rëndësishme vokalo-instrumentale si: Mesha në D – dur K.194 nga Mozart, 'Vespro della Beata Vergine 1610' nga Monteverdi, Kantatat Nr.8 nga Bach-u, 'Gloria' nga Vivaldi, Mesha në C – dur nga Beethoveni dhe 'Mass In tempore belli' nga Haydn-i. Puna e korit që ndërprerë me dhunë në fillim të viteve 90 nga regjimi serb ndërsa u rithemelua në vitin 2003 mirëpo këtë herë si njësi e institucionit më të lartë në vend, Filharmonisë së Kosovës. Me aktivitetin e tij kori ka kultivuar në mënyrë të vazhdueshme traditën e muzikës korale në Kosovë, e cila daton që nga viti 1945. Repertori i Korit të Filharmonisë së Kosovës përfshinë vepra të epokave të ndryshme stilistike që nga mjeshtrit e vjetër të muzikës vokale (C. Monteverdi, T. Morley, J. Arcadelt, L. Marenzio) deri te veprat e kompozitorëve të njohur të muzikës bashkëkohore (B. Britten, A. Part, G. Ligeti, E. Whitacre etj.). Vend të posaçëm në repertorin e korit zë literatura e muzikës shqiptare. Kori ka pasur paraqitje të rregullta me koncerte "A capella" në Kroaci, Shqipëri dhe Maqedoni ndërsa në shtator të vitit 2016 u prezantua në koncertin e organizuar në nderim të Nënës Terezë në Vatikan, në vigjilje të shenjtërrimit të saj. Kori bashkëpunon edhe me dirigjent mysafir mes së cilëve veçohen: Marko Vatovec, Damijan Mocnik, Baki Jashari dhe Marcio da Silva. Së fundi Kori i Filharmonisë së Kosovës ka realizuar një turne në Angli, prezantim i cili u vlerësua lartë edhe nga kritika britanike.

RAFET RUDI u lind në Mitrovicë, më 1949. Studimet i kreu pranë Akademisë së Muzikës në Beograd, ku diplomoi në degën e dirigjimit dhe atë të kompozimit. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Sarajevë, kurse specializoi për një vit shkollor në Konservatorin Kombëtar të Parisit, në klasën e kompozitorit Claude Ballif më 1979/80. Në periudhën 1980 - 1987 ishte dirigjent permanent i Korit Profesional të Radiotelevizionit të Prishtinës. Merret me botime dhe ka mbi 300 shkrime të ndryshme në eseistikë, recensionë, kritikë, etj. Të botuar ka disa libra shkollorë, si dhe librin teorik "Sprova estetike." Është udhëheqës i Qendrës Kosovare për Muzikën e Re dhe themelues i Festivalit Ndërkombëtar të Prishtinës - ReMusica. Aktualisht është Profesor në Akademinë e Muzikës në Prishtinë, ku ligjëron lëndën e Formave të muzikës dhe Kompozimin dhe dirigjent i Korit të Filharmonisë së Kosovës. Rudi është laureat i shumë shpërblimeve dhe mirënjohjeve si Çmimi i Dhjetorit të Kosovës për krijimtari, Çmimi i Festivalit Ndërkombëtar BEMUS, Çmimi vjetor i SHKK për vitin 1982 etj. Veprat në vijim janë disa nga veprat kryesore të tij si, "Simfonia", "Koncert" për kitarë dhe orkestër harkore, "Kohë koncertante" për piano dhe orkestër simfonik, Kuartet harkor, "The return" për mexosoprano dhe orkestër simfonik, "Afresk arbëresh III" për sopran, kor, 2 piano, organo, recitator dhe shirit manjetik, "Icare ubi es" për mexosoprano, kor, timpanë, gong, trangël, 2 piano, etj. Veprat i janë ekzekutuar në Francë, Zvicër, Mbretërinë e Bashkuar, Itali, SHBA, Japoni, Holandë, Rusi, Shqipëri, Rumani, Spanjë, Suedi, Bullgari, Kroaci, Slloveni etj. Nwn drejtimin e z. Rudi pwr herw tw parw pwr publikun mbarwshqipwtar prezantohen vepra me rwndwsi tw chmuar historike, sich janw veprat e Gjergj Danush Llapacaj (shek XIII), Jan Kukuzeli (shek XIII) dhe Niket Dardani (Nicetas i Remesianwvs, shek IV). Që nga viti 2014 Rudi është anëtar i Akademisë Europiane te Shkencave dhe Arteve.

ORGES MALAJ që nga viti 2006 punon pranë Orkestrës Sinfonike të Teatrit të Operas dhe Baletit të Tiranës si fagotist i parë, përderisa punën e tij si pedagog dhe udhëheqës i katedrës së instrumenteve të frymës dhe të muzikës së dhomës, ai e drejton që nga viti 2008. Malaj është fitues i shumë garave, ndër to veçohet: çmimi i parë i konkursit „Pjetër Gaci“. Gjithashtu, Malaj është fagotist i parë i Orstrës Rinore të Tiranës dhe Filharmonisë së Tiranës. Është anëtar i Kuintetit të Frymës "Çesk Zadeja" të themeluar në vitin 1986. Që nga viti 2006 është antar i formacionit "Trio Emerson Tirana" me të cilin ansambël ka pasur mbi 50 koncerte në Shqipëri dhe jasht saj. Krahas koncerteve me ansamble të ndryshme ai ka realizuar koncerte të shumta solistike me orkestra si në vend ashtu edhe jasht. Aktualisht është pedagog në Fakultetin e Muzikës në Universitetin e Arteve Tiranë.

31 Maj May

Amfiteatri i Bibliotekës
Universitare | 20:00

TUBA RECITAL

THOMAS LELEU tubë | tuba
ARTEMIDA QARRI HAXHIAJ piano



George Frideric Haendel

Concerto en sol

Alexej Lebedjew

Concerto pour tuba nr1

Fahri Beqiri

Alla Turca (piano solo)

Camille Saint-Saens

Mon coeur s'ouvre à ta voix
Bacchanale

Georges Bizet

Danse Bohème

Lepo Sumera

1981 (piano solo)

Astor Piazzolla

Tango Etude nr 3 pour tuba solo

Astor Piazzolla

Oblivion

Amilcare Ponchielli

La danse des heures

Villa Lobos

Tristorosa

Vittorio Monti

Csardas

THOMAS LELEU është tubist i parë të ketë fituar shpërblimin “Zbulimi i Solistit Instrumental i Vitit” në garën e Grammy-vë Franceze, Victoires de la musique classique.

Me vetëm 31 vjet, Thomas Leleu konsiderohet si “yll botëror i tubës” (Europe 1). Ky gjeni absolut (La Nouvelle République), i mirënjohur nga kolegët e tij, qysh tash ka një karrierë mbresëlënëse. Thomas Leleu është prodizhe që shfaqë muzikalitet dhe shkathtësi befasuese. Ai është tubist i parë i Orkestrës Filharmonike të Marsejtit që nga mosha 19 vjeçare. Në 2012 Thomasi fitoi “Zbulimi i Solistit Instrumental të Vitit” në garat vjetore të muzikës klasike në Francë, Victoires de la musique classique. Më 2017, ai zgjidhet “Yll i së ardhmës” në kanalin ARTE në Berlin nga Rolando Villazon.

Thomasi rregullisht ftohet të performoj në festivale dhe salla koncertale nga e gjithë bota, me orkestra si: Konzerthaus Berlin, Festspiele Mecklenburg-Vorpommern (Gjermani), Brandenburgische Sommer Konzerte (Gjermani), Mito Festival, Junge Sinfonie Berlin, Radio France-, ReMusica Festival (Kosovë), Grand Théâtre de Provence (Aix en Provence), Maison de Radio France, Théâtre du Châtelet (Pariz) etj. Thomasi shpesh ftohet të marr pjesë në programe të ndryshme televizive dhe të radios, në France 2 dhe France 3 (televizioni kombëtar Francez), Europe 1, Arte Channel, France Musique, etc.

Në 2015, albumi i tij “In the mood for tuba” është prodhuar nga Fondamenta / Sony Music. Në 2017, ai inçizoi “Impressions for tuba” me Orkestrën Mbretërore të Forcave Ajrore të Belgjikës. Albumi i tij i fundit “Stories...” është publikuar në 2019 me shtëpinë ARS-Produktion me TL Trio. Thomasi themeloi disa ansamble unike dhe te paprecedentë të tubës, siç është **Thomas Leleu Sextet** (tubë dhe kuintet harqesh) dhe **Tuba VS Cello** (tubë dhe violonçel), **TL Trio** (tubë, piano, vibrafon). Më 2017 themeloi programin **The Tuba's Trip** organizuar nga Claude Tissier (ish anëtar i Cirque du Soleil) dhe ko-prodhuar me Opéra de Marseille. Që nga 2011 është “**Melton Meinel/Weston Artist – Ambassador Buffet Crampon**”. Ai ka punuar me firmën prestigjioze 2250 TL “French Touch” tubën në të cilën momentalisht performon.

